

VENDIM
Nr. 358, datë 20.5.2026

PËR MIRATIMIN E PROJEKTEVE FITUESE TË FINANCUARA PËR VITIN 2026
NGA FONDI PËR DIGAT DHE TË AUTORITETIT KONTRAKTOR PËR ZBATIMIN E
PROJEKTEVE, SIPAS NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 8, të nenit 15, dhe të pikës 10, të aneksit 7, “Fondi për digat”, të ligjit nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së projekteve fituese të financuara për vitin 2026 nga fondi për digat dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Albana Koçi

SHTOJCA NR. 1

Nr.	Bashkia	Lloji i investimit	Objekti (emërtimi i projektit)	Vlerësimi sipas pikëzimit	Vlera e plotë e projektit	Përqindja e investimit për vitin 2026 (%)	Vlera përfundimtare e projekteve fituese, që do financohet nga AKMC-ja	Autoriteti kontraktor	Projekt i ri viti 2026	Financimi për 2027 (në lekë)
1	Tepelenë	Diga	“Rehabilitimi i digës së rezervuarit Turan, Bashkia Tepelenë”	115	75,407,819.20	43	32,425,362.26	Bashkia	2026	42,982,456.94
2	Peqin	Diga	“Rehabilitimi i digës së rezervuarit në fshatin Vashaj, Bashkia Peqin”	113	37,965,024.00	52	19,741,812.48	Bashkia	2026	18,223,211.52
3	Pukë	Diga	“Rritja e qëndrueshmërisë së digës së ujëmbledhësit Kukaj, Pukë”	110	38,927,821.98	52	20,242,467.43	Bashkia	2026	18,685,354.55
4	Lezhë	Diga	“Ndërrhyrje emergjente për riparimin e digës Kallmet, Bashkia Lezhë”	102	39,778,545.74	52	20,684,843.78	Bashkia	2026	19,093,701.96
5	Finiq	Diga	“Rehabilitimi i rezervuarit të Pandalejmonit”	95	26,828,297.00	52	13,950,714.44	Bashkia	2026	12,877,582.56
6	Vorë	Diga	“Rehabilitim i digës Shargë”	95	46,570,215.75	52	24,216,512.19	Bashkia	2026	22,353,703.56
7	Skrapar	Diga	“Rehabilitimi i digës së rezervuarit Staraveckë, Bashkia Skrapar”	93	34,618,937.17	52	18,001,847.33	Bashkia	2026	16,617,089.84
TOTALI					300,096,660.84		149,263,559.91			150,833,100.93